

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, departamenti pergjithshem-divizioni civil, gjyqtari Enes Mehmeti me procesmbjatesen Minire Krasniqi, ne ceshtjen juridike te inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga Ferizaj rr "[REDACTED]" nr. [REDACTED], perfaqesuar ng av. [REDACTED] nga Ferizaj kunder te paditurit [REDACTED] me pare nga [REDACTED], tani me adresë të panjohur të cilin në këtë procedurë e përfaqëson Përfaqësuesi I Përkohshëm av. [REDACTED] nga Ferizaj, për vërtetim pronësie, në seancën emabjtur me date 20.04.2016, në praninë e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqjese, ka marr dhe publikuar kete:

AKT GJYKIM

APROVOHET, në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditesit [REDACTED] nga [REDACTED]

DETYROHET I padituri [REDACTED] më parë nga [REDACTED] tani me adresë të panjohur, që paditesit [REDACTED] t'ia njoh të drejtën e pronësisë ashtu që të lejon, të njejtin, të regjistron në regjistrat kadastral kompetent, në emrin e tij, paluajtshmerinë e cila evideontohet me numer P-7221767-00264-0 ZK Papaz ZKK Ferizaj, me sipërfaqe prej 13788 m², e cila gjindet ne fshaitn Papaz ne vendin e quajtur "Shpat", toke bujqesore e klasit 3, në të kundërtën ky aktgjykim paditesit do t'i shërben si titull juridik per regjistrimin e te drejtes se tij te pronesise mbi pronen si me larte, ne afat prej 15 ditesh pas potefuqishmerise se ketij aktgjykimi.

OBLIGOHET paditesi qe te paguan taksen gjyqesore per aktgjykim ne shume prej 50.00, si dhe shpenzimet e procedures per perfaqesueisin e perkohshem ne shume prej 810.00€, €, pas pranimit te ketij aktgjykimi, nen kercenimin e pasojave ligjore.

Arsyetimi

Paditesi, permes te autorizuarit te tij, ne padi dhe parashtrimet ne seanca ka pretenduar se mbi pronen obekt kontesti ka fituar te drejten e pronesise ne baze te blerjes, kur te njejten ne vitin 1972 e ka blere babai i tij nga I padituri, mbi bazen e kontrates gojore dhe se per token babai i tij ia ka paguar te paditurit cmimin shites.

Prej asaj kohe e mbajne ne posedim dhe e shfrytezojne kete prone sit e tyren dhe asnjhere nuk kane pasur pengesa qofte nga I padituri, familjaret e tij apo personat e trete lidhur me posedimin dhe shfryteziimin e kesaj prone por edhe per pronesine faktike qe kemi mbi pronen.

I ka propozuar gjykates qe kerkesepadia te parovohet si e bazuar.

Perfaqesuesi I perkohshem I te paditurit, ka deklaruar ne fjalen e tij perfundimtare se lidhur me pretendimet e paditesit jane plotesuar te gjitha kushtet ligjore qe gjykata te vendos perkitazi me pronesine dhe se ia le ne vleresim gjykates ceshtjen e bazueshmerise se kerkesepadise se paditesit.

Gjykata me qellim të vertëtimit të drejte të gjendjes së fakteve të cesties ka bere adminsitrimin e provave si vijojne: degjimin e deshmitareve [redacted] dhe [redacted] mendimi dhe konstatimi i ekspertit të gjerodezise [redacted] certifikata e proensise dhe skica e matjeve per pronen.

Gjykata pas analizimit të provave të ceshtjes, të cilat i ka cmuar vec e vec dhe të nderlidhura në teresi, në kuptim të nenit 8 të LPK-se, ka gjetru se duhej vendosur si në dispozitiv për keto arsye.

Gjykata në kete procedure ka vertetuar faktin se babai I paditesit dhe pas vdekjes së tij, paditesi, kanë marr në posedim dhe e shfrytesonin-ojne tani e tutje pronen objekt kontesti. Kjo ka ndodhur qe nga viti 1972 e tani e tutje. Kete rrethane gjykata e vertetoi mbi bazen e deshmise së deshmitareve të degjuar në rast.

Gjykata poashtu vertetoi faktin se parardhesi I paditesi e me pas paditesi pronen obejkt kontesti e ka shfrytëzuar me mirebesim duke qene se nga deshmit e deshmitareve u provua fakti se babai I paditesit kete prone e ka blere nga i padituri, mbi bazen e kontrates gojore.


Gjykata vlereson se paditesi, ka fituar të drejten e pronesise mbi bazen e mabjtjes me mirebesim për mbi 20 vite, bazuar në nenin 28.4 të LBMJP-se të ish RSFJ-se/1978.

Gjykata ka obligor paditesin si në piken II të dispozitivit bazuar në UA nr.2008/2 të KGJK-se për unifikimin e taksave gjyqesore, ndersa për shpenzimet e perfaqesuesit të perkohshem bazuar në nenin 81.2 të LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.73/08 date 20.04.2016

Gjyqtari,
Enes MEHMETI



Keshilla juridike: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te te njejtit, ne gjykaten e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ESHTË I PLOTËNDOSHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAJMA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROSEVAC

Më
Dana 04. 07. 2016

